



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjiilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E drejta e Konkurrencës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta e Konkurrencës
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i I -rë, semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Ligjërata: (L) G-1 09:00-10:45, A26 (E enjte) (L) G-2 11:00-12:45, A26 (E enjte) Ushtrime: (U) G-1 11:00 -11:45, A25 (E shtune) (U) G-2 11:45-12:30, A25 (E shtune) (U) G-3 12:30-13:15, A25 (E shtune) (U) G-4 13:15-14:00, A25 (E shtune) Salla:A26 (L) & A25 (U) Asistent: Burim HALITI, Kontakti: tel: +37744785857, emaili: burimhaliti@live.com
Mësimdhënësi i lëndës:	Gani ASLLANI
Detajet kontaktuese:	Tel: +37744213250 , emaili: ganasllani@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Njoftimi, përgaditja dhe aftësimi i juristeve të ardhshëm, sidomos të atyre që do të punojnë në Institucione , që i referohen fushës financiare, që zbatojnë metodat më të përshtatshme dhe më adekuate për zgjidhjen e problemeve nga kjo fushë. Aftësimi për interpretimin e dispozitave juridike nga fusha e konkurrencës dhe qështjeve juridiko financiare.
Qëllimet e lëndës:	Fitimi i njohurive bazë, elementeve dhe veçorive të së Drejtës së Konkurrencës, praktikave të mbrojtje dhe zhvillimit të konkurrencës me orientim nga ekonomia e tregut. Në këtë modul do të trajtohen qështje si p.sh: çfarë janë marrëveshjet anti-konkurrese, masat kundër marrëveshjeve anti-konkurrese, masat kundër abuzimit me pozitën dominuese në treg, bashkimin e ndërmarrjeve dhe përqendrimeve, ligjeve dhe dispozitave të veçanta të cilat ndalojnë ushtrimin e praktikave

	kufizuese në treg, etj. Gjithashtu studentët do të fitojnë njohuri të bazë sa i përket kufizimeve të ndihmës së shtetit, rolit dhe praktikave të Komisionit Evropian në këtë fushë dhe pasojat për Shtetet Anëtare, vendeve fqinje si dhe trajtim do të këtë Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës ne Kosovë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	1. Marrin informacione dhe njohuri të mjaftueshme mbi të drejtën e konkurrencës; 2. Kuptojnë rendësin e mbrojtjen dhe zhvillimin e konkurrencës si kusht për zhvillim ekonomik dhe orientim nga ekonomia e tregut; 3. Njoftohen me fushat bazë dhe specifike ku konkurrenca mund të cenohet; 4. Avokojnë te akteret tjerë sidomos me rregullatorët ekonomik në zhvillim të saj 5. Përfitojnë njohuri shtesë për ligjet tjera te cilët mund te krijohen të drejta ekskluzive, favore apo dhënie tjera me qëllim të liberalizimit të tregut dhe rritje të konkurrueshmerise.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	5	10
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	2	5	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike, Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë teme		

	apo punimi seminari. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlerësimi i punimit. Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, me qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane: prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar. Në disa raste atyre do të prezantohen edhe ligjërata autentike nga universitetet e ndryshme perëndimore.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 25 pikë Testi i dytë: 25 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (5 detyra x 2 pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 30 pikë <u>Totali: 100 pikë.</u> Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	- Dr. Gani Asllani, E drejta e Konkurrencës, Prishtinë, 2013 - Dr. Mehdi Hetemi “ Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut” 2005
Literatura shtesë:	- Council Regulation (EC) No. 1/2003, 16 December 2002, on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty - Whish, Richard and Bailey, David, Competition Law, Oxford University Press, USA; 7 edition, 2012.

	- Colino, S. Marco, Competition Law of the EU and UK, Oxford University Press, USA; 7 edition, 2011. - Faure, Michael and Zhang, Xinzhu, Competition Policy and Regulation: Recent Developments in China, the U.S. and Europe, Edward Elgar Pub, 2011 - Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, nr. 03/L - 229 2010. Kosovë - Ligjit për Ndihmë Shtetërore Nr .04/-L-024, 2010. - Ligji Nr. 04/L-226 “Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229, 2013.
--	--

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i programit, hyrje në të drejtën e Konkurrencës
<i>Java e dytë:</i>	Historiku i zhvillimit dhe mbrojtjes së Konkurrencës
<i>Java e tretë:</i>	Baza ligjore dhe rregullat përcjellëse
<i>Java e katërt:</i>	Marrëveshjet e Ndalura, përjashtimet nga marrëveshjet e ndaluara
<i>Java e pestë:</i>	Konstatimi i Pozitës Dominuese, abuzimi me pozite dominuese
<i>Java e gjashtë:</i>	Përqendrimet dhe bashkimet, realizimi i tyre dhe notifikimi
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i Parë
<i>Java e tetë:</i>	Roli i Autoriteteve Kombëtare të Konkurrencës
<i>Java e nëntë:</i>	Rregullimi i Konkurrencës në BE
<i>Java e dhjetë:</i>	Institucionet ndërkombëtare dhe rajonale të Konkurrencës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Konkurrenca në vendet e Rajonit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Programet Moderne për rritjen e efikasitetit të autoriteteve nacionale në zhvillimin dhe mbrojtjen e konkurrencës
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Procedura e hetimeve të rasteve, marrjes së vendimeve dhe mbrojtja e lëndëve në Gjykatë
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Ndihmat Shtetërore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi Përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore, - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore, - Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim, - Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit
